



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL - LIPJAN
DREJTORATI I INSPEKTORATIT



DREJTORATI I INSPEKSIONIT

Datë :	03.11.2025
Referencë	11-344/10
Për :	Imri Ahmeti-Kryetar i Komunës
Kopje:	Diamant Bytyqi-Nënkryetar i Komunës
Nga:	Flamur Sylejmani-Drejtori i Inspeksionit
Lënda :	Raporti i muajit-tetor

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Gjatë muajit tetor Drejtoria e Inspektoratit ka ndjekur agjendat e caktuara dhe ka realizuar inspektime të ndryshme në kuadër të kompetencës, duke përfshirë të gjitha lokalitetet në territorin e Komunës.

Inspektorët e tregut - Në këtë muaj janë inspektuar subjektet të ndryshme afariste rreth regjistrimit të biznesit në ARBK- Lipjan dhe pranimit teknike të lokaleve për të ushtruar aktivitetin e tyre biznesor, janë inspektuar marketet ushqimore krahasimi i çmimeve se a janë vendosura afër artikujve të ekspozuar dhe a janë të dukshme për konsumatorin, origjina e mallit dhe vendosja e flamujve, krahasimin e çmimeve raft-arkë se a janë në përputhshmëri.

Ankesat e konsumatorëve, ku gjatë blerjeve kanë hasur në parregullsi dhe i kemi trajtuar siç parashihet me ligj.

Po ashtu gjatë muajit është inspektuar tregu i gjelbërt, kafshëve dhe tregu i produkteve jo ushqimore.

Inspektori i ambientit-mjedisit- Janë bërë kontrolla për Leje Mjedisore Komunale tek objektet në ndërtim e sipër rr. “Fehmi Agani” , Rr. “Hamdi Bislimi” Rr. “Haradin Bajrami”, Rr.”Sadik Shala” në Lipjan por edhe jashtë qytetit. Inspektimi është bërë në lidhje me zbatimin e kushteve të lejes mjedisore komunale. Gjatë inspektimit janë vërejtur disa parregullsi sa i përket mos grumbullimit të mbeturinave në vendpunishte. Janë dhënë urdhëresa për grumbullimin e tyre dhe vendosjen në kontejner. Gjithashtu janë shqiptuar edhe gjoba mandatorë për mos respektim të urdhëresave Sipas ankesave të bëra për dëmtim të rrjetit të kanalizimit, në fshatin Llugaxhi, pastaj vendosje të shaktave për rrjet elektrik në kanale të ujërave atmosferik, dëmtim të rrugëve në fshatrat Torinë, Poturovc, Dobraj e Madhe gjatë shtrirjes së rrjetit elektrik. Keds-it i është bërë shkresë zyrtare përmes e-mailit për dëmtimet e bëra, dhe është kërkuar që të sanohen problemet e tilla. Disa problematika janë sanuar dhe disa janë ende në procese të sanimit.

Është bërë inspektim në deponit ilegale në fshatrat Gadime e Ulët, Sllövi, rruga për në fshatrat Kojškë, Rubovc dhe fshatra të tjera.

U jemi përgjigjur ankesave të pranuar nga qytetarët për ndotje ajrit si pasoj e ndezjes së mbeturinave për hedhje të materialeve inerte në prona publike dhe private, të gjitha rastet janë shqyrtuar sipas ligjeve në fuqi.

Inspektorët e trafikut- Gjatë muajit tetor janë bërë inspektime të firmave të autobusëve në disa fshatra dhe Lipjan, auto-taksive, radio-taksit, firmat e autobusëve janë kontrolluar për rend të udhëtimit dhe janë urdhëruar që të respektohet rendi i udhëtimit ashtu si është lëshuar nga organi kompetent.

Inspektim në fshatin Torinë sipas ankesës nga një firmë e ndërtimit , se nuk po lëviz uji në pesetën për ujërat atmosferike, është ndaluar në vendin e ngjarjes me punëkrysin i cili ka zhvilluar punimet

për vendosjen e rrjetit elektrik nëntokësor dhe kemi urdhëruar që të shikohet se a është lidhur në gypin kryesor.

Inspektori i ndërtimit- janë realizuar inspektime të vazhdueshme në teren. Kanë inspektuar objekte të cilat posedojnë leje ndërtimi dhe është konstatuar gjendja e tyre me procesverbal si dhe ndaj ndërtimeve të filluara pa leje ndërtimi është konstatuar gjendja me procesverbal dhe aktvendim për ndalimin e punëve dhe vendosjen e shiritave zyrtar. Pra, nga inspektori i ndërtimit janë realizu, procesverbale, fletëparaqitje dhe vendosje të shiritave

Drejtoria e Inspektoratit është përgjegjgur në të gjitha ankesat e pranuar nga qytetarët në formë të shkruar, elektronike apo përmes telefonatës.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUdhËS RAPORTUESE

Punët dhe aktivitetet e realizuara gjatë muajit tetor janë:

Janë realizuar urdhëresa për pranime teknike të lokaleve afariste si dhe janë bërë pesë pranime teknike të lokaleve afariste.

Ndalimi i shitjes jashtë tregut.

Inspektimi dhe parandalimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore dhe inspektimi i objekteve me leje ndërtimi.

Vendosje të shiritave zyrtar.

Gjoha mandatore.

Aktvendime.

Inspektimi-kontrollimi i firmave të autobusëve në qytet dhe fshatrat.

Inspektim i rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe jashtë qytetit.

Inspektimi i auto-taksive në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Vrellë.

Inspektim për kushtet e LMK-së dhe zbatimin e tyre ndaj investitorëve të objekteve me shumë njësi banimi.

Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve në teren me kohë sipas ligjeve dhe rregulloreve komunale.

STATISTIKAT

Inspektorët	Gjithsej inspekte	Inspekte me procesverbal	Pranime teknike	Fletëparaqitje	Njoftime nga DPMUMM-ja	Kontrolla për leje Mjedisore komunale	Vendosje të shiritave	Vërejtje, njoftime	Punë me palë, ankesa , kërkesa	Lendet e pranuar	Lende te pezulluara, ekzekutuara gjyqësore	Konfiskim i targave, librezës dhe kthim	Gjoba mandatore	Te hyra nga pranime teknike	Inspektim i bizneseve pa pranime teknike	Menaxhim i tregjeve	Aktivendime, ndalesa, urdhëresa	Kallëzim penal	Inspektim me polici	Inspektim i bizneseve pa regjistrim
Biznesi	151	23	14						57	17				225.00€	6	12	19			3
Ambienti	31	8				6		2	6	7			1						1	
Ndërtimi	58	21			35		1		1											
Trafiku	63	11						28	10	2						8			4	
Gjithsej	303	63	14		35	6	1	30	74	26			1	225.00€	6	20	19		5	3

DISKUTIMET PUBLIKE

Diskutime publike nuk kemi mbajtur.

TAKIME TË TJERA

Takimet janë mbajtur me pronar të bizneseve, pronar të ndërtimeve, me taksistë dhe qytetarë të tjerë.

SFIDAT

Inspektimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore.

Inspektimi i bizneseve të paregjistruara, pa pranime teknike.

Ndalimi i hedhjes së mbeturinave inerte në tokat bujqësore, mbrojtja e hapësirave gjelbëruese.

Inspektime të auto-taksive, firmave të autobusëve në qytet dhe në fshatra si dhe inspektimi i taksive ilegal në ANP.

REKOMANDIMET

Rekomandojmë qytetarët të cilët hasin në ndonjë parregullsi e cila trajtohet me kompetencë nga Inspektorati Komunal të na njoftojnë në Drejtorin e Inspektoratit.